

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hashim Çollaku kryetar i kolegjit, gjyqtarët Ferit Osmani dhe Gani Zabeli anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Leonita Lajçi, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit R.B., nga fsh. ... K.Podujevë, për shkak të veprës penale vjedhja e pyllit, nga neni 358 par.2 të KPK-së, duke vendosur sipas ankesës së mbrojtësit të akuzuarit, R.B., av.M.N., të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.4113/2016, të dt.30.07.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me 20.09.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit R.B. av. M.N., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.4113/2016, të dt.30.07.2018, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.4113/2016, të dt.30.07.2018, është shpallur fajtor i akuzuari R.B., për shkak të veprës vjedhja e pyllit, nga neni 358 par.2 të KPK-së, dhe të njëjtit i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) muaj, i cili dënim më pëlqimin e të akuzuarit i është zëvendësuar në dënimin më gjobë, në shumë prej 3000 (tremijë) euro, e të cilin dënim i akuzuari do ta paguaj në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I akuzuari është obliguar që të paguajë të dëmtuarës Autoriteti Pyjor Komunal në Prishtinë, që t'ia kompensojë dëmin e shkaktuar në shumë prej 517.50 euro.

Te akuzuarit R.B., i kthehet automjeti i konfiskuar i tipit xhip ‘’ Isuz Troper’’, më targa XYZ-KS-XYZ.

I akuzuari, obligohet që të paguaj shpenzimet e procedurës penale në shumë prej 20 (njëzet) euro, si dhe paushallin gjyqësor, sado qw tw jetw sipas llogaritjws sw tw njwjtit nw arkw tw gjykatws.

Kundër këtij aktgjykimi, në afat ligjor ka ushtruar ankesë, mbrojtësit së të akuzuarit R.B., av. M.N., për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, duke propozuar që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, dhe të akuzuarit ti shqiptohet një dënim më i butë më gjobë.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë, me shkresën PPA/II.nr.948/2018, të datës 11.09.2018, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e ushtruar, ka propozuar që e njëjta të refuzohet si e pabazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenit 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesa e ushtruar, propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, si dhe shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

Ankesa e mbrojtësit të akuzuarit R.B. av.M.N., nuk është e bazuar.

Meqenëse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, gjykata duke vepruar në pajtim me nenin 394 të KPPK, e shqyrtoj aktgjykimin e ankimuar nëse i njëjti është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, dhe gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit, të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij, për të cilat kjo gjykatë kujdeset kryesisht sipas detyrës zyrtare.

Sipas ankesës së mbrojtësit të akuzuarit, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, është ankimuar për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, duke theksuar se gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së vendimit për dënimin, të akuzuarit i ka shqiptuar dënim të ashpër, pasi që i njëjti e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, pastaj drunjti i janë konfiskuar nga pala e dëmtuar dhe vlera e dëmit të shkaktuar me këtë veprë penale është shumë e vogël, duke shtuar se gjykata ka marr për bazë vetëm rrethanat rënduese e të cilat në këtë rast janë elementet e figurës së veprës penale. Andaj, në prani të rrethanave të theksuara, mbrojtja ka propozuar që ti shqiptohet dënim më i butë më gjobë.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, ankesën e ushtruar, si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim, se nga ana e gjykatës së shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë është vërtetuar gjendja faktike, se aktgjykimi i ankimuar nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave e të procedurës penale, si dhe shkeljet e ligjit penal, ashtu që kolegji pas vlerësimit të aktgjykimit, vie në përfundim se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë me rastin e marrjes së vendimit për dënimin, caktimit të llojit dhe lartësisë së tij, në kuptim të nenit 73 të KPK-së, sikurse janë rrethanat lehtësuese, se i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, se i akuzuari ka pasur sjellje korrekte në gjykatë, se është penduar për veprën e kryer penale, gjithashtu ka vlerësuar edhe rrethanat rënduese, ka vlerësuar edhe ankesën, nga e cila kolegji i kësaj gjykate vie në përfundim se nuk është paraqitur ndonjë rrethane posaçërisht lehtësuese, andaj në prani të këtyre rrethanave, kolegji i kësaj gjykate është i bindur se me dënimin e shqiptuar sikurse në dispozitiv të aktgjykimit do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij i paraparë me nenin 41 të KPK-së, që të parandaloj kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëj rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëj kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale, dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PA1. nr.940/2018, të datës 20.09.2018

B.profesionale
Leonita Lajçi

Anëtarët e kolegjit
Hashim Çollaku

Kryetari i kolegjit
Ferit Osmani

Gani Zabeli